

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS SË OSBE-së,
AMBASADORIT EUGEN WOLLFARTH NË KONFERENCËN E KRYETARËVE
TË NJËSIVE TË QEVERISË VENDORE**

28 shtator 2011

Kryetarë bashkish e komunash dhe anëtarë këshillash,
Të nderuar miq,
Zonja dhe zotërinj,
Mirëmëngjesi!

Më lejoni në radhë ta parë t'u uroj mirëseardhjen në emër të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri gjithë kryetarëve të bashkive dhe komunave dhe kryetarëve të këshillave të pranishëm këtu sot.

Më lejoni, gjithashtu, t'ju përgëzoj të gjithëve për fitoren tuaj në zgjedhjet e muajit maj, ndërkohë që një numër të konsiderueshëm prej jush kam pasur kënaqësinë ta takoj personalisht pas ditës së zgjedhjeve.

Siç e dini, unë i kam ndjekur nga afër zgjedhjet dhe më kanë lënë mbresa të thella energjia e fushatave tuaja dhe përkushtimi i qytetarëve për të votuar për t'ju zgjedhur si drejtues për komunitetin e tyre.

Shpesh dëgjojmë shprehjen 'qeveria vendore është qeveria më afër njerëzve'?

Në fakt, unë do shkoja edhe më tej duke thënë se "Qeveria që qeveris më afër njerëzve qeveris më mirë nga të gjitha!"

Drejtuesit e vërtetë e dinë çfarë duhet dhe ndërmarrin hapat e duhur për t'u shkuar punëve deri në fund!

Ju tashmë jeni në një pozicion kyç ku mund të sillni ndryshimin në jetën e qytetarëve të zakonshëm në komunitetet tuaja.

Juve ju është dhënë detyra dhe detyrimi fisnik për t'i shërbyer gjithë komunitetit dhe për të lënë pas një trashëgimi pozitive për brezat e ardhshëm.

Ju ftoj ta shfrytëzoni siç duhet këtë moment!

Shpërblimi më i madh që duhet të prisni është që do të keni nderin t'i shërbeni komunitetit tuaj!

Unë ju ftoj të përqafoni plotësisht standardet e përsosmërisë në punën tuaj të përditshme bazuar në parimet e ndershmërisë, transparencës, efikasitetit, përgjegjshmërisë, etikës, integritetit, dhe administrimit të shëndoshë të financave publike.

Unë ju ftoj:

- Të veproni si një model shembull për praktikën etike dhe për një proces demokratik;
- Të siguronit një vizion për ofrimin e shërbimeve publike komunitetit;
- Të komunikoni me qytetarët dhe ta përfshini publikun në vendimmarrje;

- Të krijoni një klimë profesionale pune;
- T'u paraprini dhe t'i zgjidhni vështirësitë e komunitetit;
- Të avokoni për nevojat e autoriteteve tuaja vendore në forume të tjera; dhe
- Të nxisni bashkëpunimin përtej ndarjeve politike për të mirën e komuniteteve tuaja.

Më lejoni të ritheksoj edhe një herë dy pikat e fundit.

Ju duhet të keni në dispozicion mjetet dhe burimet e duhura për të kryer detyrat tuaja në shërbim të së mirës publike.

Juve ju duhet po ashtu edhe një organ kombëtar dypalësh proaktiv që mbron interesat vendore dhe që ju mbështet ndërkohë që ju zgjeroni shërbimet vendore.

Pavarësisht përkatësive politike, përpiquni të punoni së bashku për të lobuar pranë qeverisë qendrore për nisma shtetërore që ndikojnë në komunitetet tuaja.

Është në interes të komuniteteve tuaja që ju të jeni konstruktiv dhe, ndonjëherë, jopartiak, për të garantuar se qytetarëve u shërbehet më mirë nga vendime të marra në nivel vendor.

Një shoqatë e qeverisë vendore ofron platformën ideale për promovimin dhe mbështetjen e nevojave vendore dhe për ndarjen e informacioneve dhe praktikave më të mira.

Një shoqatë ofron një forum për krijimin e aleancave përtej partive për çështje me interes të përbashkët vendore si reformat e planifikimit territorial dhe decentralizimit.

Një shoqatë duhet, gjithashtu, të jetë në gjendje të ndërtojë një axhendë legjislative të përvitshme dypalëshe për qeverinë vendore dhe të nxisë koalicione të gjera të nevojshme për kalimin e ligjeve të dobishme në Kuvend dhe për të mos lejuar miratimin e ligjeve që dëmtojnë njerëzit në komunitetet tuaja.

Në fund do të dëshiroja t'ju ftoja të rigjallëroni shoqatën e bashkive dhe t'u jepni komuniteteve tuaja një zë të fortë në politikat kombëtare që ndikojnë në jetën tuaj.

Një shoqatë e suksesshme ka nevojë për mbështetjen tuaj aktive.

Më lejoni ta mbyll duke ju falënderuar për përkushtimin tuaj në ofrimin e shërbimeve për publikun.

Duke ju uruar gjithë të mirat për katër vitet e ardhshme të mandatit tuaj, më lejoni të theksoj edhe një herë se ne mbetemi të gatshëm t'ju ofrojmë mbështetje kur ju keni nevojë për të.

Ju falënderoj shumë dhe ju uroj punë të mbarë!

Fund

KONTROLLO PËRKUNDREJT FJALIMIT TË MBAJTUR